

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË–DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Jonuz Bugari, si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarëve porot: **Selami Gashi** dhe **Mustafë Cena**, anëtar të trupit gjykues, me bashkëpunëtorin profesional **Armond Omega**, në çështjen juridike të propozueses S. K. e lindur K. nga fshati K. e M., Komuna e Rahovecit, të cilën e përfaqëson avokati Q. Q. nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, dhe propozuesit M. K. nga fshati Ç., Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson i autorizuari A. Th. nga fshati Ç., Komuna e Rahovecit, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të zgjidhjes së martesës me marrëveshje, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor jo publik dhe zbatimit të provave, më **02.07.2018**, morri këtë:

A K T G J Y K I M

ZGJIDHET ME MARRËVESHJE martesë në mes të propozueses **S. K.** e lindur **K.**, lindur më ..., dhe propozuesit **M. K.**, i lindur më ..., martesë e lidhur më ..., në Zyrën e Gjendjes Civile në Rahovec – Ç., me nr. ser. **M ...**, me nr. rendor ..., dhe me numër të referencës **16|2014RM|16009**.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Propozuesit S. K. e lindur K. dhe M. K., nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, në këtë gjykatë kanë parashtruar propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, kanë cekur jeta martesore, në formën dhe përmbajtjen çfarë zhvillohej në mes të palëve ndërgjyqëse, nuk ka qenë qëllimi i fundit i tyre, ngase bashkësia martesore e ka humbur kuptimin për faktin se propozuesja gjatë tërë kohës së martesës ka jetuar dhe jeton në Kosovë, ndërsa propozuesi jashtë Kosove, për që arsye të dy palë janë marrë vesh në mes veti që më së miri është që martesë e cila ka humbur kuptimin ligjor për shkak të mungesës së bashkëjetesës, ta zgjidhin me marrëveshje pa asnjë problem, ngase në këtë martesë nuk kanë lindur fëmijë, e as nuk presin lindjen e tyre.

Në lidhje me këtë çështje juridike gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor për datën 02.07.2018, në të cilën seancë është paraqitur propozuesja S. K. e lindur K. personalisht si dhe përfaqësuesi i autorizuar i saj av. Q. Q. dhe për propozuesin e dytë i autorizuari A. Th..

Përfaqësuesi i autorizuar i propozueses së parë ka deklaruar se palët ndërgjyqëse kanë lidhur martesë me datën ..., në Zyrën e Gjendjes Civile në Ç., në këtë martesë fillimisht raportet në mes tyre kanë qenë të mira dhe të dytë kanë jetuar në Gjermani. Në këtë martesë nuk kanë lindur fëmijë, e as nuk presin lindjen e tyre në ndërkohë për shkak të mosmarrëveshjeve, në mes të tyre raportet janë përkeqësuar në atë masë sa që propozuesja S. është kthyer në Kosovë dhe ka shkëputur bashkësinë me bashkëshortin e saj ashtu që me ndërmjetësim të miqve janë marrë vesh që më mirë për të dyja palë është që martesën ta zgjidhin me marrëveshje dhe secili të kërkojë fatin e vetë. Për këtë arsye i propozoj gjykatës që martesën e ndërgjyqësve ta zgjidh sipas propozimit të përbashkët me marrëveshje, sa i përket shpenzimeve palët janë marrë vesh që secila palë ti bartë shpenzimet e veta personale.

I autorizuari i propozuesit të dytë deklaroi se në tërësi ka ngelur pranë propozimit të përbashkët në lidhje me prishjen e martesës me marrëveshje, i vërtetoi thëniet e cekura në propozim si dhe thëniet e

të autorizuarit të propozueses së parë, prej vitit 2013 propozuesit kanë jetuar bashkërisht në Gjermani mirëpo para rreth një viti ata jetojnë ndaras propozuesja S. K. jeton në fshatin K. e M. tek prindërit e vet, ndërsa propozuesi i dytë jeton dhe punon në Gjermani. Gjatë martesës së tyre ata nuk kanë lindur fëmijë e as që presin lindjen e fëmijës, dhe i propozoj gjykatës që të aprovoj propozimin e përbashkët dhe martesë në mes të propozuesve të zgjidhet me marrëveshje.

Gjykata, për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike ka bërë administrimin e provave dhe atë: ka bërë shikimin e certifikatës së martesës ser. M ..., me nr. rendor ..., dhe me numër të referencës 16|2014RM|16009, e lëshuar pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Rahovec, më 22.09.2017, si dhe në cilësi të palës është dëgjuar propozuesja S. K..

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave, në bazë të bindjes së lirë, e duke u bazuar në nenin 8 të LPK-së, është konstatuar se propozimi i përbashkët i propozuesve për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, është i bazuar dhe i njëjti është aprovuar.

Me shikimin në certifikatën e martesës me nr. serik M..., e lëshuar pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Rahovec, data 22.09.2017, nga e cila vërtetohet se M. K. i lindur me ... në fshatin Ç., dhe S. K. e lindur me ..., në fshatin K. të M., kanë lidhur martesë më datën ..., dhe të njëjtën datë është bërë regjistrimi i saj në librat amë.

Propozueses S. K. nga fshati K. e M., pasi që i është tërhek vërejtja që të flas të vërtetën me pasojat juridike në lidhje me këtë çështje juridike deklaroi: se kemi lidhur kurorën në Janar të vitit 2013, në fillim rreth 3 viteve të para kam jetuar në fshatin Ç. në familjen e bashkëshortit tim, më pastaj i kam rregulluar letrat dhe kemi pasur bashkim familjar kam jetuar në Gjermani deri me 17 dhjetor 2017, mirëpo për shkak të mosmarrëveshjes në mes nesh unë jam kthyer në fshatin K. të M. tek prindërit e mi jetoj, ndërsa ai ka vazhduar jetën në Gjermani, gjatë martesës tonë unë nuk kam lindur fëmijë e as që presin lindjen e fëmijës dhe për shkak të mos marrëveshjes që kemi pas në mes veti kemi vendosur që të bëjmë propozimin e përbashkët për prishjen e martesës.

Si fakt relevant në këtë çështje juridike gjykata muar për bazë se propozimin për zgjidhjen e martesës me marrëveshje palët e kanë bërë bashkërisht, dhe se ka mbi një vit jetojnë ndaras sipas deklaramit të tyre.

Andaj në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë dhe duke u bazuar në dispozitat neneve 68, 69 dhe 84 të Ligjit mbi Familjen i Kosovës dhe nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
C.nr. 169/2018, më 02.07.2018.

B. Profesional
Armond Qmega

Kryetari i trupit gjykues
Jonuz Bugari

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet ndërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit Divizioni Civil në Prishtinë.